

Myslym Shyri
S. Pitarka 24/b
P.O Box 154,
Tirane 1001

Artikujt në vijim

Të rinjtë

Vullnetarizmi

Modelet Pozitive të
komunitetit Rom

Mundësi Studimi

Roma Versitas
Albania

Roma Education
Fund– Bursat
RMUSP

Bursa Sociale për
nxënësit Rom dhe
Egjiptian.

Romanipe

NUMRI 2

DHJETOR 2014

Publikuar nga Instituti I Kultures Rome ne Shqiperi me mbeshtjetjen e
Open Society Foundation/ RIO

Të Rinjtë Rom, Çelësi I Ndryshimit.

Korpusi Rom i Vullnetarëve përbëhet kryesisht nga studentë rom dhe jo-rom të cilët përfshihen në fushata ndërgjegjësuere që synojnë nxitjen e qytetarisë aktive tek të rinjtë dhe krijimin e një ambjenti social gjithëpërfshirës e ndërkulturor. Të gjithë anëtarët pajisen me kartën e vullnetarit dhe përveçse angazhimit në aktivitete vullnetare, mbahen të informuar me të rejat dhe zhvillimet e fundit rreth mundësive për trajnime, zhvillim kariere dhe punësim.



Aktualisht Korpus Rom i Vullnetarëve numëron rreth 60 të rinj rom dhe jo-rom.

Dita Botërore e Vullnetarizmit

Dita Ndërkombëtare e Vullnetarizmit është vendosur nga Asambleja e Kombeve të Bashkuara në vitin 1985, me qëllim falenderimin e vullnetarëve për përpjekjet e tyre në komunitet dhe për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për të kontribuar në shoqëri. të Kombeve të Bashkuara.

Cilat janë tematikat e kësaj dite?

Çdo vit fushatat kanë një temë të caktuar. Tematikat e zhvilluara kanë lidhje me mbrojtjen e mjedisit; ndarjen e eksperiencave dhe praktikave të suksesshme në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM), etj.

Cilat janë arsyet që mund të bëhesh vullnetar?

Ekzistojnë shumë arsye pse njerëzit zgjedhin të bëhen vullnetar. Arsyet kryesore janë:
Për të ndihmuar të tjerët,
Për të kontribuar për një kauzë dhe
Për të përmirësuar jetën e të tjerëve.

Të Rinjtë Rom, Çelësi i Ndryshimit.

Në 12 Qershor 2014.
**Instituti i Kulturës Rome
në Shqipëri (IRCA) dhe
Korpusi rom i
Vullnetarëve**, organizuan
konferencën e Vullnetariz-
mit pranë Universitetit
European të Tiranës (UET).

Kjo konferencë pati në fokus
krijimin e një përkufizimi mbi
termin e vullnetarizmit të
ndërtuar nga studentët Rom
dhe jo-rom, shkëmbim experi-
encash positive të studentëve
Rom, tashmë modele pozitive të
këtij komuniteti si dhe shpër-
darje e kartave të vullnetarizmit

nga Korpusi Rom i Vullnetarëve studentëve të cilët kanë kontribuar për kauzën Rome.
Gjatë punëve në grup u evidentuan përkufizime të ndryshme të cilat të bashkuara sëbashku
formojnë përkufizimin që studentët Rom dhe jo-Rom i dhanë termit Vullnetarizëm:

*“Vullnetarizmi është ndërthurja e dëshirës me vullnetin e një apo më shumë individësh të cilët
përkushtohen për të ndihmuar, fuqizuar komunitetin dhe advokuar për një kauze të caktuar.”*



Modelet Pozitive të Komunitetit Rom.



Quhem Naze Ymeri, studioj për infermieri të pergjithshme.

Per me shume se dy vite kam dhënë kontributin tim në arsimimin e fëmijëve të minoritetit Rom , duke u ofruar asistencë në mësimet suplementare për përgatitjen e detyrave në lëndë të ndryshme si: matematikë , kimi, fizikë, letërsi dhe anglisht. Prej 3 muajsh kam mësuar fëmijët në gjuhën angleze, gjithashtu kam organizuar aktivitet për matjen e tensionit arterial dhe matjen e nivelit të glicemise në gjakë . Aktualisht jam duke përgatitur disa trajnime për gratë dhe fëmijët e komunitetit rom për çështje të ndryshme shëndetësore . Pjesëmarrëse në fushatat e advokimit për zgjidhjen e problematikave të çështjes romë.



Më quajnë Olsi Sherifi. Studioj për gazetari në vit të tretë në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë.

Prej disa vitesh jam anagzhuar në çështjen Rome duke dhënë kontributin tim si gazetar i ardhshëm nëpërmjet shkrimit në blog apo artikujve me qëllim zbutjen e stereotipeve. Kam qenë pjesëmarrës në protestat që kanë organizuar komuniteti i Selitës si media e lirë qytetare, kam patur shansin të referoj problematikat e minoritetit rom në Shqipëri në Parlamentin Europian.



Une quhem Behije Kodra dhe aktualisht jam në vitin e dytë të studimeve Bachelor pranë Universitetit Bujqësor të Tiranës në degën e Teknologji ushqimore.

Prej 2 vitesh vullnetare aktive tek Koprusi Rom I Vullnetarëve duke marrë pjesë dhe kontribuar në organizimin e aktiviteteve të ndryshme si: Flash-Mob, Marshime, Trajnime për rritjen e kapaciteteve të rinjve Rom dhe Egjiptian në fushën e advokimit, të drejtave, të medias etj. Interesi im për kauzën rom është shumë i lartë për vetë faktin sepse mendoj se minoriteti rom është një minoritet kultural dhe së cilit akoma është e pazbuluar dhe njohur nga shoqëria shqiptare.

Mundësi Studimi

ROMA VERSITAS ALBANIA

është një Program i financuar REF - ROMA EDUCATION FUND që ka për qëllim rritjen e nivelit dhe kapacitetin akademik të studentëve Rom dhe Egjiptian që vazhdojnë studimet universitare, dhe kjo nëpërmjet mentorimit dhe tutorimit, Gjithashtu, përveçse ndihmesës individuale të çdo studenti përfitues i këtij programi nëpërmjet leksioneve shtesë të lëndëve që do të zgjedh studentit me ndihmën e mentorit dhe të asistuar nga lektorë, do të ketë mundësinë e frekuentimit të kurseve falas të gjuhës angleze, kurseve informatike, të gjuhës rome. Përpos këtyre do të realizohen ëorkshop-e të ndryshme në funksion të studentit si dhe 10 grante (5 vitin e parë dhe 5 vitin e dytë).

DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM PËR APLIKIM:

1. Formularin e aplikimit të plotësuar;
2. Vërtetim regjistrimi nga Fakulteti ku jeni duke frekuentuar studimet si dhe Listën e notave;
3. Kopje të Dëftesës së Shkollës së Mesme, ku duhet të përmbajë listën e notave të të gjitha viteve shkollore (kjo vlen për ata student të cilët janë regjistruar në vitin e parë të universitetit);
4. Fotokopje të Kartës së Identitetit;
5. Një Letër Motivimi (afërsisht 300 – 500 fjalë) lidhur me përzgjedhjen e fakultetit/degës së studimit dhe synimit për të ardhmen pas përfundimit të studimeve;
6. Një fotografi.

BURSAT PER STUDENTET ROM

1. Informacion I përgjithshëm për bursat RMUSP.

NIVELI I MBËSHTETJES

REF mund të mbështesë një aplikant nën skemën e bursave të RMUSP, gjatë studimeve të tij/saj, për një maksimum prej 8 vitesh si vijon:

Një Bachelor, për maksimumi 4 vjet në modelin e integruar të studimit, dhe për maksimumi 3 vjet brenda sistemit të Bolonjës, me transferim në një tjetër universitet/ fakultet /fushë studimi të lejuar vetëm një herë;

Një Master, për maksimumi 1 vit në modelin e integruar të studimit, dhe për maksimumi 2 vjet brenda sistemit të Bolonjës;

Një Doktoraturë, për maksimumi 3 vjet; Shuma bazë e bursës RMUSP është llogaritur mbi bazën e 80 eurove në muaj akademik;

Bursa RMUSP është menduar të mbulojë shpenzimet shkollore të tilla si tekstet shkollore, tarifat e provimit, dhe pjesërisht shpenzimet e jetesës; Në varësi të disponueshmërisë së fondëve, Programi mund, sipas gjykimit të vet, gjithashtu të mbulojë shpenzimet e pjeseshme, ose të plotë për mësimdhënien për maksimumi 1,200 euro për vit akademik, si pjesë e bursës; megjithatë, Programi nuk garanton se shumta e bursës do të mbulojë pjesërisht ose totalisht shkollimin për një aplikant të suksesshëm; Bursat nuk jepen automatikisht për vitin pasues akademik; studentët mund ta rinovojnë aplikimin dhe të konkurrojnë në çdo cikël të bursave (viti akademik), për të cilin ata marrin mbështetje nga REF PS-së;

Aplikantët mund të aplikojnë për skemat e ndryshme të bursave REF të njëjtën kohë, nëse u jepet e drejta sipas kriterëve të kërkuara të pranimit të çdo skemë. do të kërkohej të zgjedhë vetëm një bursë dhe të njoftojnë zyrtarisht REF PS për vendimin e tyre. .

Bursa Sociale për nxënësit Rome dhe Egjiptian

ARSIS Organizatë Shoqërore e Përkrahjes së të Rinjve në partneritet me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë (MMSR) me mbështetjen e Roma Education Fund (REF) hap thirrjen për BURSAT SOCIALE (për nxënësit Rom dhe Egjiptian që janë aktualisht në klasë të 9-të) të bazuara në meritë dhe vlerësimit të gjëndjes social-ekonomike për vitin akademik 2014-2015.

Qëllimi i këtyre bursave është të përmirësojë regjistrimin, kalimin nga klasa e 9-të në klasën e 10-të dhe deri në përfundim të arsimit të mesëm. Gjithashtu synohet përmirësimi i arritjeve akademike për 80 nxënës romë dhe egjiptianë për vitet akademike 2014- 2018 në arsimin e mesëm dhe atë profesional në qarqet e Tiranës dhe të Durrësit.

Dokumentacioni I nevojshëm:

1. Formulari aplikimit i plotësuar;
2. Vërtetim nga shkolla që nxënësi ndjek klasën e nëntë dhe nivelin e frekuentimit të orëve të mësimi;
3. Dëftesën e notave të vitit të shkuar akademik (klasa e 8-të);
4. Vërtetim nga Zyra Rajonale e Punësimit në rast se prindi është i papunë ose nga Zyra Rajonale e Tatim-Taksave
5. Deklaratë e plotësuar nga prindi i nxënësit aplikant në të cilën shprehet përkatësia etnike Rome dhe/ apo Egjiptiane si dhe miratimi i prindit për të aplikuar për bursë në rast se nxënësi aplikant është nën 18 vjeç.
6. Çertifikatë personale dhe familjare